Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 563/01
Datë 11.12.2014

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/14- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 11.12.2014 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për akreditimin e Agjensioni për Përkrahje dhe Punësim në Kosovë në Prishtinë, për periudhën 3 vjeçare, 11. 12. 2014 deri 30.11.2017 për:

1.1. Gjuhë gjermane

Akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

1. Të hartojë politikë për ngritjen e vazhdueshme profesionale, adekuate të stafit të zhvillojë një sistem efektiv për zbatimin dhe mbikëqyrjen e realizimit të kësaj politike.
2. Të krijojë mekanizma monitorues që mësimi të realizohet sipas standardeve të Kornizës së Përbashkët Evropiane.
3. Të sigurojë që stafi mësimdhënës të ketë ngritjen e duhur akademike apo trajnime relevante, sidomos për nivelet më të avancuara (C1-C2). Të zhvillojë politika, aty ku mungojnë.

Afati kohor për plotësimin e të gjitha këtyre kushteve është 31.05.2016.

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit me datë: 13.11.2014, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Raportin e Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
Raporti i Vetë-vlerësimit;
Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi i dërgohet:
   - APPK; dhe
   - AKK.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi